**Hapet thirrja për aplikime për bursa trajnimi në Universitetin e Ekonomisë në Varna, Bullgari, për stafin me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës për semestrin e dytë të vitit akademik 2020 - 2021.**

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për trajnim për stafin me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës.

https://international.ue-varna.bg/

**Llojet e mobilitetit:**

-Shkëmbimin e stafit ndihmës akademik me karakter administrativ / administrativ për trajnim;

**Kohëzgjatja:**

- 5 ditë + 2 ditët e udhëtimit (mobiliteti duhet të kryhet pas datës 16 korrik 2021 dhe duhet të përfundojë deri në datën 31 korrik 2021);

**Bursat përfshijnë:**

-Kompensimin ditor për stafin (140 EUR në ditë);
-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

| **DISTANCA E UDHËTIMIT** (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm) | **Kompensimi** |
|---|---|
| **Midis 100 dhe 499 KM** | 180 EUR |
| **Midis 500 dhe 1999 KM** | 275 EUR |
| **Midis 2000 dhe 2999 KM** | 360 EUR |
| **Midis 3000 dhe 3999 KM** | 530 EUR |
| **Midis 4000 dhe 7999 KM** | 820 EUR |
| **8000 KM ose më shumë** | 1100 EUR |

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:
http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

**Dokumentat e nevojshme për aplikim:**

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj;

-Vetëdeklarim nëse jeni shpallur fitues ose keni kryer një bursë shkëmbimi Erasmus+ më parë (nëse po, ku)
- Plani i mobilitetit për trajnim*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën: https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Training_outgoing-1.docx

*Plani i Mobilitetit për trajnim është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së trajnimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +.

**Afati për aplikim**: 15 Qershor 2021

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!